



American School of Kosovo
Educating the leaders of tomorrow. For a better future.

ÇERDHJA PËR FËMIJË

PLANPROGRAMI
PËR MOSHAT
2 DHE 3 VJET





Planprogrami i çerdhës së ASK-së për fëmijë "ASK Nursery" është i bazuar në një planprogram amerikan, i cili është përdorur në programin "Fillo – Udhëhiq / Head-Start" dhe Akademinë për Fëmijë me bazë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky planprogram promovon mësimdhënien me standarde të larta të përsosmërisë dhe pritshmërinë e më të mirës nga të gjithë nxënësit tanë.

Programi i çerdhës së ASK-së për fëmijë fokusohet që të sigurojë një përvojë fillestare pozitive të të mësuarit për çdo fëmijë, gjë që i garanton fëmijës sukses të hershëm dhe i hap rrugën për një fillim pozitiv të të gjithë përvojës së të mësuarit.

Programi ynë është i mirë-balancuar dhe ofron programe zhvillimore ditore (një ditë të plotë) të përshtatshme për moshën e fëmijëve duke përdorur një shumëllojshmëri teknikash të mësimdhënies, në mënyrë që nxënësit e ASK-së të arrijnë nivelet e përsosmërisë, dhe ne përpiqemi që këtë ta arrijë çdo fëmijë.

Për këtë nivel të fëmijërisë së hershme, planprogrami përqëndrohet në zhvillimin e aftësive sociale, ndërtimin e vetë-besimit, dhe pavarësinë e fëmijës, duke i mësuar ata se si të kujdesen për veten. Përveç zhvillimit të këtyre shkathtësive sociale, ne punojmë gjithashtu për të zhvilluar shkathtësitë e komunikimit duke përdorur gjuhën ekspresive (e të shprehurit): shkathtësinë për të artikuluar zëshëm nevojat, dëshirat, mendimet dhe idetë, duke përdorur një gjuhë të pranueshme: shkathtësinë për të ndjekur udhëzimet, dhe shkathtësitë e gjuhës angleze për fëmijë, të cilët nuk i kanë shkathtësitë bazë të gjuhës angleze.

Ne e ndihmojmë secilin fëmijë të arrijë nivelin e tij / saj të suksesit, duke aplikuar lojëra të ndryshme, artin, këngën, lojërat me gishta, dhe aktivitete të tjera fizike.



Përveç punës për zhvillimin e shkathësive sociale dhe komunikuese, programi synon të zhvillojë tek fëmijët edhe shkathësitë e mira motorike. Sa i përket shkathësive të përgjithshme motorike ne synojmë që t'i mësojmë fëmijëve tanë të mësojnë të përdorin muskujt e tyre të vegjël, si ato (muskujt) të dorës, duke prerë figura të ndryshme, duke pikturuar me gjishta, duke përdorur lapsa dhe aktivitete të tjera të bukura që rrisin shkathësitë motorike. Sa i përket shkathësive të përgjithshme motorike, ne inkurajojmë zhvillimin e kontrollimit të mirë të trupit përmes aktiviteteve fizike, siç janë: kërcimi, të hedhurit pupthi (poshtë-lart) dhe hedhja e topit.

Planprogrami akademik i çerdhes për fëmijë përfshin:

A. SHPREHITË E LEXIMIT;

1. Të kuptuarit se leximi është burim i dijes
2. Trajtimi i librave me respekt
3. Dallimi ndërmjet fotografive dhe printimeve
4. Vendosja e pjesëve të ndryshme të një libri



B. TË LEXUARIT DHE TË KUPTUARIT:

1. Ri-tregimi i ngjarjes/ historisë
2. Ri-leximi i ngjarjeve / historive të preferuara

C. LEXIMI I TINGUJVE:

1. Njohja e renditjes së alfabetit
2. Identifikimi i tingujve dhe shkronjave të alfabetit
3. Njohja e fjalëve që rimojnë


D. SHPREHITË E TË SHKRUARIT:

1. Përdorimi i shkronjave, simboleve dhe fotografive për të treguar përrallat
2. Të fillojnë të dëgjojnë të shkruarit e dikujt tjetër dhe të lexojnë shkrimin e tyre
3. Të fillojnë të mbajnë një koleksion të shkrimit të tyre

E. TË SHKRUARIT PËR NJË QËLLIM:


1. Të shkruajmë në mënyrë që të:

- Komunikojmë
- Tregojmë një histori/ ngjarje
- Për kënaqësi



F. KONCEPTET E NUMRAVE DHE ARITMETIKËS:

- Numërimi i objekteve deri në 10
- Identifikimi i numrave dhe emërtimeve të tyre deri në 10
- Praktikimi i shkathësive të numërimit nga një numër i caktuar
- Krahasimi i dy grupeve dhe dallimi se cili grup ka më shumë, më pak apo njëjloj



G. PROCESI MATEMATIKOR

- Bisedë rreth përdorimit të matematikës në jetën e përditshme
- Lojëra duke përfshirë ndarjen dhe klasifikimin
- Vendosja e objekteve sipas rradhës

